



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 18.2.2020, ora 11:30

**Drejton mbledhjen:**

**Enver Roshi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit te datës 16.2.2021.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë” (*Komision përgjegjës*)

**Marrin pjesë:**

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Klotilda Bushka, Adelina Rista, Almira Xhembulla, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Amra Barova, Ervis Meço, Edmond Stojku Halil Jakimi, Roland Xhelilaj.

**Të ftuar:**

Mira Rakacolli – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale

Gelardina Prodani – Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale

## HAPET MBLEDHJA

**Enver Roshi** – Mirëmëngjesi, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Së pari, në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të datës 16.2.2021.

A jeni dakord me procesverbalin e datës 16.2.2021? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Së dyti, kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë mbi dhurimin në fushën e shëndetësisë”. Komisioni e shqyrton këtë nismë në cilësinë e komisionit përgjegjës. Relatore është zonja Klodiana Spahiu.

Nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale marrin pjesë Mira Rakacolli, zëvendësministre dhe zonja Gelardina Prodani, sekretare e Përgjithshme.

Sipas rregullit fjalën e ka zëvendësministrja e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, zonja Mira Rakacolli.

**Mira Rakacolli** – Faleminderit!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale ka sjellë para komisionit për shqyrtim dhe për miratim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë për dhurimin në fushën e shëndetësisë”, në lidhje me një donacion për një spital regjional që do t’i shërbejë rajonin të Jugut, i cili do të ngrihet në qytetin e Fierit.

Parimi bazë i shëndetësisë sonë ka qenë dhe mbetet ai i mbulimit shëndetësor universal, që do të thotë sigurimi i një shërbimi cilësor, të qëndrueshëm, të aksesueshëm, të përballueshëm për të gjithë, duke pasur gjithmonë qytetarin në qendër dhe, duke i pasur parasysh këto, edhe sa më afër vendbanimit.

Në fakt, të gjithë jemi dëshmitarë të arritjeve në këtë drejtim dhe se sa shumë është përmirësuar shërbimi shëndetësor pranë vendbanimeve qoftë në infrastrukturë, qoftë në aparatura dhe në burime njerëzore. Mjafton t’ju përmend këtu ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur në infrastrukturën e ndërtimit të rreth 300 qendrave shëndetësore në këto 4 vjet, të cilat jo vetëm janë

ndërtuar, por edhe janë pajisur mirë. Po kështu ndërtimi i spitaleve të tilla, siç është spitali kirurgjikal këtu në Tiranë, pjesë e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, siç është spitali i ri i urgjencës në Elbasan, si dhe ndërtimi i materniteteve në Lezhë dhe në Kukës, spitali i ri në Kukës, materniteti i ri i Sarandës, i Korçës, i Beratit, si dhe përmirësimi në infrastrukturë i pothuajse të gjitha spitaleve rajonale në Shqipëri.

Po kështu jemi dëshmitarë që në këto spitale është përmirësuar ndjeshëm pajisja me aparatura. Mjafton t’ju përmend që sot të gjitha spitalet rajonale kanë mamografi dhe aparatura skaneri, për të mos folur më pas për rezonancat, të cilat i janë shtuar spitalit të Elbasanit dhe tashmë po i shtohen edhe spitalit të Korçës.

Por, ajo çka është më e rëndësishme në drejtim të shërbimit sa më në kohë dhe sa më cilësor të pacientëve, nuk duhet të harrojmë që vetëm para 8 vjetësh ndërhyrjet e hemodinamikës bëheshin për një kohë të caktuar dhe jo gjatë 24-orëve për të sëmurët që kishin nevojë dhe vuanin nga sindroma koronare akute, duke rrezikuar të bënin infarkt miokardi deri në humbje jete, vetëm në një orë të caktuar në Spitalin Universitar “Nënë Tereza” në shërbimin e hemodinamikës, kështu që një pjesë e mirë e tyre detyroheshin ta merrnin shërbimin në strukturat private kur kishin nevojë.

Sot, jo vetëm që ky shërbim ofrohet 24 orë në këtë qendër spitalore, është krijuar qendra e hemodinamikës në spitalin “Shefqet Ndroqi” dhe janë krijuar qendra hemodinamike edhe në Shkodër, edhe në Fier, për t’u shërbyer pacientëve të këtyre rajoneve në një kohë sa më të shpejtë.

Po kështu, po të flasim për burimet njerëzore, ka qenë një shpërndarje mjaft më e mirë e tyre, qoftë me politikat e respektimit të kontratave të atyre që mbarojnë specialitetet, qoftë me politikën e patronazhimit, qoftë edhe me politikën e bonusit për t’u afruar qytetarëve shqiptarë shërbimin shëndetësor cilësor afër vendbanimit. Megjithatë, ne jemi të ndërgjegjshëm se ka akoma shumë për të bërë, jemi të ndërgjegjshëm që, pavarësisht flotës së autoambulancave të shtuara, përmirësimit të infrastrukturës rrugore, nuk arrijmë t’ua plotësojmë të gjitha nevojat afër vendbanimit dhe mjaft qytetarë për patologji të ndryshme detyrohen të vijnë në Tiranë dhe një pjesë e tyre mundet të kërkojnë të zgjidhin problemet edhe jashtë kufijve të Shqipërisë.

Për këtë arsye qeveria shqiptare ka bërë një marrëveshje për të marrë një donacion nga qeveria turke për të ndërtuar një spital të një kategorie të lartë cilësore në drejtim të infrastrukturës, teknologjisë dhe të asistencës mjekësore për t’i shërbyer gjithë infrastrukturës së Jugut, pra do të jetë një spital regional.

Ky spital do të ofrojë një nivel kujdesi shëndetësor, i cili sot për sot nuk ofrohet në asnjë nga spitalet rajonale të qyteteve, të cilave do t'u shërbejë. Do të jetë një spital, i cili do të ketë pavijone ose më saktë shërbime për të gjitha llojet e shërbimeve të mjekësisë interne, duke filluar me kardiologjinë, me hematologjinë, me gatiapatologjinë, endopatologjinë, me nefrologjinë, me neurologjinë, do të ketë ofrim të ndërhyrjeve kardiokirurgjikale, ose më saktë interventeve të shpejta kirurgjikale kardiake, siç janë për shembull, jo vetëm ato të hemodinamikës ose të ndërhyrjeve që bëhen sot në spitalin e Fierit, por edhe vendosje të divajseve të ndryshme, siç janë pesmejkerat opo divajse të tjera që shërbejnë për përmirësimin e strukturës së zemrës. Ky do të jetë një spital, i cili në drejtim të urgjencës neurologjike do të ofrojë edhe një trombolizë, ashtu siç bëhet sot vetëm në QSUT-në “Nënë Tereza”, pra duke bërë që pacientët që kanë nevojë për trombolizë, për të cilën është shumë e rëndësishme koha kur duhet të pacientët e atij regjioni duhet të paraqiten për të marrë shërbimin.

Njëkohësisht, do të sigurojë edhe ekzaminime më të hollësishme, qoftë në drejtim të funksioneve kardiake, qoftë në drejtim të funksioneve polmonare, qoftë në drejtim të funksioneve neurologjike, ku përfshihen patologjitë e gjumit, do të jetë vendosja e një EZH-eje holter, që nuk është sot as në QSUT. Pra, e thënë shkurt, do të jetë një spital i cili do të afrojë një kujdes shumë të mirë, cilësor që tashmë është i munguar për vendet e rajonit të Jugut.

Shumë e rëndësishme është që qeveria turke ka marrë angazhimin për ta bërë në një kohë shumë të shkurtër, pra për 3 muaj. Ky angazhim i qeverisë turke patjetër që kërkon edhe një angazhim nga qeveria jonë. Nëpërmjet ratifikimit të kësaj marrëveshjeje, pra ky angazhim konsiston në lehtësimin që bëhet për qeverinë turke që të gjitha materialet, që shkojnë për ndërtimin e këtij spitali, ashtu sikurse të gjitha orenditë dhe aparaturat, të jenë të përjashtuara nga detyrimet doganore, nga detyrimet tatimore apo nga taksat e tjera që janë pjesë e legjislacionit shqiptar.

Nga ana tjetër, me këtë marrëveshje që kërkohet të ratifikohet kërkohet që materialet, të cilat blihen në Shqipëri, të jenë të përjashtuara nga taksa e vlerës së shtuar, pra nga TVSH-ja.

**Enver Roshi** – Ju lutem, sa më shkurt!

**Mira Rakacolli** – Unë, pasi thashë se çfarë është ky spital dhe sa i rëndësishëm, dua të argumentoj dhe pikat që ka kjo marrëveshjeje që kanë të bëjnë me lehtësimin e procedurave doganore, me mospagimin e taksave, të tatimeve për materialet që janë për këtë spital.

Nga ana tjetër, duke i dhënë të drejtën qeverisë turke për të pasur marrëdhënie kontraktuale me kompani turke të afta dhe të përshtatshme për të realizuar ato qëllime që ka spitali dhe, njëkohësisht, edhe të kompanive me origjinë joturke që ndoshta ajo i quan të përshtatshme për ta bërë këtë gjë.

Në këtë marrëveshje është parashikuar sesi do të jetë tranzicioni, pra kalimi nga ndërtimi, që do të jetë krejtësisht përgjegjësi e palës turke, sesi do të kalojë në një administrim shqiptar. Në këtë marrëveshje janë përcaktuar të gjitha këto procedura. Për shkak të rëndësisë që ka ky investim për shëndetësinë shqiptare, ju ftoj që pas një diskutimi ta miratoni këtë marrëveshje.

**Enver Roshi** –Faleminderit, doktoreshë Mira!

Në cilësinë e kryetarit të këtij komisioni, pa dyshim edhe unë e mbështes këtë nismë ambicioze të qeverisë shqiptare për të bërë një spital rajonal më modern, të kohëve të fundit, në qarkun e Fierit, i plotësuar me të gjitha standardet e nevojshme të cilësisë së trajtimit, pasi mbulon një zonë të gjerë të popullsisë shqiptare, qoftë si gjeografi, por edhe si popullatë.

Natyrshëm që pas fjalës suaj fjalën do t’ia jap relatores, zonjës Spahiu, për të relatuar në lidhje me këtë marrëveshje.

Ju lutem, ndizni mikrofonin, sepse nuk dëgjoheni!

**Klodiana Spahiu** – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj të gjithë kolegët, veçanërisht doktoreshë Mirën, që na bëri një prezantim të detajuar të këtij projekti kaq të bukur. Besoj që të gjithë deputetët e qarkut të Fierit sot ndihen vërtet shumë të gëzuar për këtë projekt, i cili në një kohë rekord, vetëm për 3 muaj, do të ndërtohet në qytetin e Fierit. Në fakt, do t’i shërbejë më tepër se sa vetëm qarkut të Fierit, dhe me atë projekt ambicioz që na detajoi profesoreshë Mira, besoj se të gjithë ne jemi dakord, ndaj urojmë dhe shpresojmë se ashtu siç është bërë edhe marrëveshja, ky projekt, ky spital i ri të përfundojë brenda tre muajve.

Pra, realisht, ne nuk kemi parë ndonjëherë, që brenda një kohe kaq të shkurtër, të përfundojë një spital me 150 shtretër. Kjo është edhe arsyeja që marrëveshja ka ardhur me procedurë të përshpejtuar. Disa shtesa të marrëveshjes, që nuk janë thelbësore, ndodhen në fund të relacionit, në fund të marrëveshjes, të cilat kanë të bëjnë me disa shtesa të tjera, që ka kërkuar pala turke, për të plotësuar në detaje të gjitha nevojat e këtij spitali rajonal.

Ajo që do të shtoja, është se ky spital rajonal, në të vërtetë do të na shërbejë të gjithëve, për të parë edhe një herë se si duhet të funksionojë një spital, duke ditur se do të jetë në frymën e

një vetëmenaxhimi. Pra, këtu do të shikojmë edhe një herë të realizuar atë projekt që e kemi nisur nga programi ynë që në 20130-ën, por që realisht e kemi pasur të pamundur ta realizonim në këto vite. Kjo sepse, siç e dimë, që të vetëmenaxhohet një spital, duhet të jetë i pajisur jo vetëm me infrastrukturën, por edhe me burimet njerëzore.

Në fakt, gjithçka që përmendi doktoreshë Mira ka qenë në funksion të këtij qëllimi. Pra, në qoftë se ne kemi arritur që, me investimet e gjatë gjithë këtyre viteve, të përmirësojmë infrastrukturën e spitaleve rajonale, qëllimi ka qenë ky: të kemi një model të caktuar, që sot do ta kemi, dhe do të jetë modeli i këtij spitali, për të realizuar programin tonë në lidhje me një vetëmenaxhim spitalor. Pra, të bëjmë të mundur të ketë jo vetëm një drejtim të burimeve njerëzore, një shfrytëzim më të lartë të shtratis, si dhe që mjeku të ketë një mundësi diferencimi edhe në pagesë, në saje të punës që bën, në saje të rezultatit që jep.

Në fakt, kjo është një praktikë shumë e mirë, për t'u përshëndetur e për t'u përkrahur, në mënyrë që të rritet edhe pritshmëria e rezultati që merr pacienti, por të rriten edhe pritshmëritë që ka personeli shëndetësor, me qëllim që të vlerësohet më i miri.

Besoj se ky lloj projekti do të jetë shumë ambicioz. E vërtetë që është një donacion, dhe fillimisht do të jetë i drejtuar nga burimet turke, por me sa jemi në dijeni dhe me sa kam lexuar në marrëveshje, burimet njerëzore do të jenë tonat, do të jenë shqiptare. I gjithë personeli shëndetësor, përveç shefave drejtues, do të jetë personeli ynë. Modeli do të merret prej tyre, dhe besoj se shumë shpejt ky model do të përhapet në të gjitha spitalet rajonale të Shqipërisë, në mënyrë që në brenda pak viteve të arrijmë që, përveç forcimit të parësorit, siç u përmend me përmirësimin e treqind qendrave shëndetësore, të kemi edhe një projekt shumë të mirë spitalor. Pra, të kemi spitale rajonale shumë më eficiente se sa këto që janë sot, e njëkohësisht të arrijmë të menaxhojmë shumë mirë edhe spitalet bashkiake.

Dua të nënvizoj se vetëm dy ditë më parë është inauguruar edhe spitali i Laçit, që edhe ai do të jetë një projekt model se si mund të menaxhohet një spital bashkiak. Të gjithë e dimë që ne kemi shumë spitale bashkiakë, të cilat janë me një efikasitet shumë të ulët dhe për të bërë ose për të arritur atë që mund të bëjë një spital bashkiak, pra që të përballojë urgjencat, të përballojë shërbimin obstetrikal, të përballojë shërbimin pediatrik, ku shërbimi të jetë i specializuar duhet të shkojnë drejt spitaleve rajonale. Ne pikërisht po japim dy shembuj dhe do të jetë shembulli i spitalit rajonal të Fierit dhe shembulli i spitalit bashkiak të Laçit, për të treguar edhe një herë që ne nuk

mund të vazhdojmë më me buxhete historike në shpërndarjen e buxhetit për shëndetësinë, por duhet të arrijmë në planin tonë konkret.

Por e nënvizoj edhe një herë që për të arritur planin tonë prej shumë vitesh nuk mund të bëhej pa forcuar specialitetet, ashtu siç e përmendi doktoresha, pa u forcuar hemodinamika, pa u forcuar neurologjia, pa u forcuar kardiokirurgjia. Pra, këto janë nevoja dhe domosdoshmëri, të cilat besoj që forcimet e spitaleve rajonale do t'i realizojnë dhe do të bëjnë të mundur që qytetarët ta marrin shërbimin sa më pranë vendbanimit të tyre.

Përsëri do të doja t'ju falënderoja për këtë projekt shumë ambicioz. Kemi dëgjuar variante nga më të ndryshmet që thonë: “Pse drejt Turqisë dhe jo drejt Perëndimit?” Në fakt, ky është një donacion, dhe unë e falënderoj nga zemra qeverinë turke, sepse, në fund të fundit, është një shtet shumë i fuqishëm nga i cili ne kemi plot çfarë të mësojmë, sidomos në fushën e shëndetësisë kemi shumë për të mësuar prej tyre. Prandaj, edhe një herë, i përgëzoj edhe për kohën shumë të shkurtër brenda së cilës ato kërkojnë ta arrijnë angazhimin e tyre dhe, pa dyshim, do të jetë angazhim i të gjithë qeverisë shqiptare dhe yni në miratimin e kësaj marrëveshjeje për të përjashtuar nga të gjitha taksat dhe detyrimet, siç e dimë dhe dihet tashmë që çdo aparaturë që hyn ka një taksë, një TVSH, normal të gjitha mallrat që do të hyjnë si për ndërtimin, ashtu edhe për pajisjen, do të jenë të lehtësuara nga detyrimet fiskale. Ndaj edhe ne jemi të detyruar ta miratojmë këtë marrëveshje dhe nenet e saj, ashtu siç i shpjegoi edhe zëvendësministrja.

Ju falënderoj shumë!

Në fakt, pyetjet që unë kisha në mendje u sqaruan pak më parë nga doktoreshë Mira dhe ishin pikërisht për të ditur se çfarë specialitetesh do të mbulonte ky spital, informacion të cilin e morëm. Kështu që nuk kam pyetje të tjera në lidhje me këtë projektligj.

Faleminderit, kryetar, dhe të nderuar kolegë!

**Enver Roshi** – Faleminderit, Klodi, për shtjellimin e gjerë që i bërë kësaj marrëveshjeje në cilësinë e relatores!

Faleminderit, profesoreshë Mira, për ekspozenë e gjerë që dhatë lidhur me ndërtimin e spitalit dhe ndihmesën që jep ai për trajtimin e të sëmurëve jo vetëm për Fierin, por për të gjithë rajonin e Jugut!

Natyrshëm është një ndihmë e madhe për vendin tonë, i cili po kalon një situatë të vështirë të posttërmetit dhe gjatë COVID-it, dhe kjo është një ndihmë, një bonus që i vjen shëndetësisë shqiptare. Natyrshëm që kjo kërkon, dhe ajo që mësojmë këtu, jo vetëm është pajisja teknike,

shërbimi, por edhe menaxhimi spitalor, që e theksoi edhe doktoreshë Klodi, pra se si menaxhohet një spital në kushte moderne në kushte pandemie, por edhe me vizion kontemporan Perëndimor për të gjitha.

Po, Adelina, por, të lutem, sa më shkurt.

**Adelina Rista** – Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë fare shkurt, unë dua t’ju them që, si deputete e Fierit dhe si deputete e zonës, ku po ndërtohet spitali, jam dyfish krenare për këtë dhe e lumtur për qeverinë time, që bëri të mundur lidhjen e kësaj aktmarrëveshjeje për ndërtimin e këtij spitali, që ishte aq i domosdoshëm, pra spital rajonal në qytetin e Fierit. Dhe jo vetëm për Fierin, por ky spital do t’i shërbejë tërë Jugut dhe do t’i shërbejë tërë Jugut me ato shërbime shëndetësore, tepër cilësore, që doktoreshë Mira, profesoreshë Mira, zëvendësministrja, i sqaroi fare mirë dhe unë e falënderoj për këtë.

Fieri, faktikisht, ka një kapacitet mjekësh në spitalin e vet dhe një menaxhim shumë të mirë të atij spitali. Qeveria shqiptare ka investuar duke hapur shërbime të reja cilësore në spitalin e Fierit, si ai i hemodinamikës, i trajtimit të kancerit të gjirit e të gjitha me radhë dhe shërbimi është tejet cilësor. Tashmë me ndërtimin e spitalit rajonal, Fieri e ndien tej mase dhe prandaj unë dua të falënderoj qeverinë shqiptare, nëpërmjet fjalës në këtë komision shëndetësie, e ndien shumë fare vlerësimin në rritjen e shërbimeve shëndetësore. Pra, ka rritje të shërbimeve shëndetësore tejet cilësore.

Prandaj, shumë shkurt dua të them, shumë faleminderit, për gjithë këtë që po bëhet në Fier! Në Fier është punuar shumë faktikisht, në të gjitha drejtimet, por ndërtimi i spitalit rajonal u vuri kapakun të gjithave.

Faleminderit!

**Enver Roshi** – Faleminderit Adeliانا!

Unë besoj se për të gjithë kolegët është e qartë rëndësia e kësaj marrëveshjeje. Të gjitha dilemat dhe pyetje që ju kishit, besoj se u sqaruan këtu. Pra, e theksoj edhe një herë që, ajo është një ndihmë e madhe që i vjen popullatës shqiptare, veçanërisht zonës jugore të Shqipërisë, por edhe një eksperiencë që do të rrezatohet edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë në spitalet rajonale, por edhe ato bashkiake. Unë besoj se...

**Ilir Pendavinji** – Kryetar, dua të bëj disa pyetje.

**Enver Roshi** – Po, patjetër, Ilir.

**Ilir Pendavinji** – Faleminderit kryetar!



Faleminderit zëvendësministres për shpjegimin që dha për këtë marrëveshje, për të cilën ne të gjithë jemi dakord me dyja duart dhe të entuziazmuar për mënyrën e zhvillimit të këtij projekti madhor të qeverisë shqiptare!

Për mua është një premtim i mbajtur i qeverisë shqiptare, një premtim i mbajtur, sepse ka premtuar që do ta bëjë spitalin rajonal dhe më në fund u arrit të mbahet ky premtim.

Falënderime pa masë i shkojnë qeverisë turke, që u tregua e gatshme dhe në mënyrë shumë të shpejtë do të realizojë këtë projekt madhor për të gjithë Shqipërinë, jo vetëm për Fierin!

Kam dy pyetje, në fakt, më shumë që të sqarohen edhe qytetarët shqiptar për pjesën e investimit të këtij spitali. Sa do të jetë investimi në infrastrukturë për spitalin? Sa do të jetë investimi në pajisje i tij, në qoftë se e keni të detajuar, ministria besojë e ka të detajuar, që do të kontribuojë qeveria turke?

Ky spital që do të shkojë drejt vetëmenaxhimit, ashtu siç e shpjegoi edhe relatorja, është vërtetë projekt ambicioz i qeverisë, atje ku duhet të arrijmë. Një pyetje tjetër edhe për qytetarët shqiptarë. Sa shtretër do të ketë për shërbimin intern dhe sa do të ketë për shërbimin kirurgjikal të këtij spitali?

Këto janë disa pyetje që unë dua që të sqarohen jo vetëm për mua, por edhe për qytetarët shqiptarë, që të jenë koshientë se çfarë projekti madhor po zhvillohet në Fier, çfarë të mirash dhe çfarë benefitesh do të ketë Shqipëria, i gjithë rajoni i Jugut në këtë kohë.

**Enver Roshi** – Faleminderit!

Profesoreshë Mira, ju lutem shkurt.

Unë di që 150 shtretër ka spitali, por nuk e di sasinë e investimit dhe këtë mund të na e jepni ju.

**Mira Rakacolli** – Atëherë, siç e thamë, spitali ka 150 shtretër dhe nga këta 150 shtretër përfshihen shërbimet, si: kirurgji, urgjencë, shërbime të sëmundjeve të brendshme. Për kirurgjinë do të jenë rreth 6 salla operacioni; do të ketë rreth 30 shtretër për sëmundjet infektive; do të ketë rreth 10 shtretër për të pritur urgjencat dhe pjesa tjetër do të jetë e ndarë sipas specialiteteve të mjekësisë interne, natyrisht, duke u dhënë më tepër peshë atyre sëmundjeve që janë më të shpeshta në popullsi, siç janë sëmundjet e zemrës, sëmundjet neurologjike dhe sëmundjet e aparatit respirator, duke lënë më pak shtretër për sëmundjet endokrinologjike, që dihet se kanë më tepër ekzaminime dhe zgjidhen me më shumë me konsulta apo me shtrime të shkurtra disaditore. Pra, do të jetë një spital i mirëmenduar. E rëndësishme është që jemi marrë në mënyrë më të detajuar

me nivelin e aparaturave që do të vijnë, pasi do të vijnë aparatura nga më modernet. Për shembull, rezonanca do të jetë 1,5 tesla, do të ketë angiografi, i cili do të jetë dyplaneshë ose/dhe triplaneshë, ndërkohë që në Shqipëri angiografite janë vetëm njëplaneshë. Pra, do të ketë një angiografi që do të jetë më e përparuar se sa angiografite që janë realisht. Gjithashtu, do të ketë një aparat Holter EEG-je, të cilën nuk e ka ende edhe sot as Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, si dhe shumë aparatura, duke filluar nga aparaturat më të thjeshta, siç janë ato të EKG-ve apo EEG-ve e të tjera. Gjithashtu, do të ketë video EEG-je që do të merret edhe me pjesën e studimit të çrregullimeve të gjumit. Pra, do të bëhen edhe studime për gjumin, të cilat nuk bëhen dot as në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Pra, niveli i aparaturave do të jetë bashkëkohore dhe, siç e thashë, do të ketë jo vetëm aparatura që do t’u shërbejnë shërbimeve që sot i ofrojmë në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, pra në të vetmen qendër të nivelit tercial që ne kemi në Shqipëri, por do të ketë edhe aparatura, të cilat do të jenë të një niveli më të lartë se sa aparaturat që janë aktualisht sot në këtë qendër spitalore, pra ato që unë përmenda.

**Enver Roshi** – Faleminderit, doktoreshë!

Askush nuk ka pyetje.

Atëherë, e hedhim në votim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë për dhurimin në fushën e shëndetësisë”.

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 121/1 shkronja “ç” të Kushtetutës me propozim të Këshillit të ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë vendosi:

Neni 1: “Ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë për dhurimin në fushën e shëndetësisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

E mbyllim mbledhjen e sotme të Komisionit të Shëndetësisë.

Ju falënderoj për praninë tuaj dhe ju uroj një ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**